




REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA VUSHTRRI - OPSTINA VUCITRN



Duke vendosur në çështjen administrative, sipas Kërkesës për Rishqyrtim të dt. 27.09.2021, parashtruar nga subjekti: NNP “ Hysnia ” & “ POUK Group “sh.p.k. me seli në Vushtrri, Autoriteti Kontraktues – Drejtoria Komunale për Prokurim Publik e Komunës së Vushtrrisë, pas mbajtjes së seancës jo publike të shqyrtimit të kërkesës të subjektit në fjalë, në bazë të nenit 108/A pika 6 lidhur me pikën 10 paragrafi 10.1 të Ligjit për Prokurimin Publik në Kosovë nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, më datën 29.09.2021, merr këtë:

V E N D I M

1. Hudhet poshtë si e jashtëafatshme Kërkesa për Rishqyrtim e parashtruar nga Grupit të O.E. : NNP “ Hysnia ” & “ POUK Group “sh.p.k. me seli në Vushtrri, lidhur me Njoftimin mbi Vendimin e A.K. sipas aktivitetit të prokurimit me titull : “ Asfaltimi i rrugëve lokale në fshatra sipas Lot. 1 deri në Lot. 3 “ prok. Nr. VU644 – 21 – 022 – 511
2. Vërtetohet si i bazuar Vendimi i Autoritetit Kontraktues – Drejtorisë Komunale për Prokurim Publik i dt. 20.09.2021

A r s y e t i m

Autoriteti Kontraktues – Drejtoria Komunale për Prokurim Publik (në tekstin e mëtejme A.K.) në pajtim me dispozitat e nenit 43 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik Prokurimin Publik, në teksti e mëtejme (ROUPP) lidhur me nenin 59 të Logjit për Prokurimin Publik në Kosovë nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 në tekstin e mëtejme (LPP), më dt. 20.09.2021 ka publikuar në Platformë Elektronike të e-prokurimi Njoftimin mbi Vendimin e A.K. bashkangjitur dhe Letarat Standarde përkatëse për tenderuesit me arsyetimet e nevojshme.

Në Kërkesën për rishqyrtim, Grupi i O.E. : NNP “ Hysnia ” & “ POUK Group “sh.p.k. me seli në Vushtrri, në tekstin e mëtejme (Ankuesi) konsideron se me këtë rast A.K. ka shkelur dispozitat e LPP-së, veçanërisht nenin 1 – Qëllimi i aktivitetit të prokurimit, nenin 7 – Barazia në Trajtim/ Jo Diskriminimi, nenin 59 – Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve si dhe nenin 65 – Pranueshmeria e Kandidatëve ose Tenderuesve.

Autoriteti Kontraktues pasi ka pranuar Kërkesën për Rishqyrtim, fillimisht ka vlerësuar afatshmërinë e parashtrimit të Kërkesë për Rishqyrtim , me ç’rast ka konstatuar se Kërkesa e Grupit të O.E. : NNP “ Hysnia ” & “ POUK Group “sh.p.k. është parashtruar jashtë afatit ligjorë të saktësuar si në dispozitat e LPP-së, saktësisht nenin 5 paragrafi 1 – Kalkulimi i afateve kohore, citat : “ *afatet kohore të këtij ligji duhet të fillojnë në një ditë pune dhe të përfundojnë në një ditë pune. Afati kohor shkon deri në orën 16:00 në ditën e skadimit. Autoriteti Kontraktues mundë të vendosë që të caktojë një kohë tjetër me kusht që ai është jo më herët se në ora 12:00 të ditës së skadimit* “ mbarim citati lidhur me nenin 108/A paragrafi 3 pika 3.2, citat : “ *në rast se shkëlja e supozuar ka të bëjë me vendimin për dhënie të kontratës , Kërkesa për Rishqyrtim pran Autoritetit Kontraktues, mundë të parashtrohet brenda 5 (pesë) ditëve) pas datës së publikimit të njoftimit për dhënie të kontratës* “ mbarim i citatit.

Sikurse ka konstatuar A.K., Kërkesa për Rishqyrtim tek A.K., përmes Platformës Elektronike të E-prokurimi-t, është parashtruar më dt. 27.09.2021 në orën 20:24 min. ndërsa, afati i fundit për dorëzimin e Kërkesës për Rishqyrtim, ashtu sikurse është saktësuar në dispozitat e saktësuar si më lartë në këtë Vendim ka qenë data 27.09.2021 deri në orën 16:00, andaj rrjedhimisht ky afat nga Ankuesi nuk është respektuar dhe

për pasojë Kërkesa për Rishqyrtim konsiderohet e parashtruar jashtë afatit ligjorë prej 5 (pesë) ditëve pas afatit të fundit për dorëzimin e K.R. dhe, për rrjedhojë e njëjta është hedhur poshtë.
Nga sa u tha me lartë, e në përputhje me nenin 108/A pika 10 paragrafi 10.1 të LPP-së u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë Vendim ka të drejtë të parashtroi ankesë pranë Organit Shqyrtues për Prokurim (OSHP-së), në pajtim me nenin 109 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.

Autoriteti Kontraktues – Drejtoria Komunale për Prokurim Publik
K.R. nr. 22/2021 - datë 29/09/2021

Vendimi i dërgohet:

1. 1x Palës
2. 1 x DKP
3. 1 x Arkivit (1 kopje)

Amir Haradinaj

Drejtor i Drejtorisë për Prokurim Publik

